



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 11, datë 12.12.2017

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: "GODINË  
POLIFUNKSIONALE "EYES OF TIRANA" 5, 6, 8, 9, 11, 15, 21, 24 KATE, ME 4 KATE  
NËNTOKË, NË KRYQËZIMIN E RRUGËS SË KAVAJËS DHE RRUGËS SË DURRËSIT,  
BASHKIA TIRANË"**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregulloreve të zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozim të shoqërisë "Concord Investment" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,


**VENDOSI:**

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Godine Polifunksionale "Eyes of Tirana" 5, 6, 8, 9, 11, 15, 21, 24 Kate, me 4 kate nëntokë, në kryqëzimin e Rrugës së Kavajës dhe Rrugës së Durrësit, Bashkia Tiranë", me subjekt zhvillues shoqërinë "Concord Investment" sh.p.k dhe shoqërinë "Ideal Construction" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregulloreve të Veçantë bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Procedurat administrative/ligjore për objektin e përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, do të vijohen nga Bashkia Tiranë, sipas përcaktimeve dhe rregullave të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregulloreve të zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në përputhje me marrëveshjen përkatëse për delegim kompetencash, bashkëlidhur këtij Vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**



**MINISTËR I LINJËS**  
**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**DAMIAN GJIKNURI**



**ANËTAR / SEKRETAR I KKT**  
**DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**  
**LEDIA TOTA**

